



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.137/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.137/2024, të datës 26.01.2024, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat kundër Vendimit me numër protokoli 1255/02, të datës 29.12.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike *‘masë disiplinore-largim nga shërbimi civil’*, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.03.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.137/2024, e datës 26.01.2024, e parashtruar nga ankuesi ashtu që **ndryshohet** Vendimi me numër protokoli 1255/02, i datës 29.12.2023, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë lidhur me masën disiplinore të shqiptuar ndaj ankuesit, duke zëvendësuar masën disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”* me masën disiplinore *“Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë prej një (1) viti”*.
- II. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin të tij, duke e kthyer ankuesin në vendin e punës në pozitën *Drejtor i Departamentit të Turizmit*, sipas Akt Emërimit Ref.3/Nr.1, të datës 01.08.2022, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me marrëdhënien e punës, si dhe të bëjë kompensimin e të gjitha pagave nga dita e largimit nga shërbimi civil deri në zbatimin e këtij vendimi.
- III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil (*referuar tutje ankuesi*), përmes përfaqësuesit me autorizim me datë 26.01.2024, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 1255/02, të datës 29.12.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 01.02.2024, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa, kjo e fundit, me datë 08.02.2024, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 509/2023 të datës 26.01.2024 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 1255/02 të datës 29.12.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; Kërkesën për qasje dhe pajisje me dokumentet e datës 24.01.2024; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor të datës 13.12.2023; Kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore e datës 01.12.2023; Ankesën e datës 30.11.2023 nga K.D; Vërejtjen verbale e datës 18.12.2023 për nëpunësin A.K e shqiptuar nga ankuesi; Emailin e datës 18.12.2023, 13.12.2023 nga D.L për ankuesin; Emailin e datës 14.12.2024 nga ankuesi për D.L; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 26.12.2023; Emailin e datës 12.12.2023 nga Arkiva MINT për ankuesin; Raportet nga konsulta mjekësore; Akt Emërimit Ref.3.Nr.1 i datës 01.08.2022; Autorizim e datës 13.12.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.02.2024; Përgjigjen në ankesë e datës 08.02.2024; Emailin e datës 26.12.2023 nga A.K për D.L; Postime në rrjete sociale nga A.K, datë 16.12.2023, 06.12.2023, 15.12.2023; Ftesën për seancë të Kamionit Disiplinor e datës 11.12.2023 dhe 12.12.2023 për ankuesin; Ftesë për seancë të Komisionit Disiplinor e datës 14.12.2023 për D.L, K.D; Ftesë për seancë të Komisionit Disiplinor e datës 26.12.2023 për Z.Sh; Emailin e datës 27.12.2023 nga ankuesi për D.L; Emailin e datës 26.12.2023 nga N.Sh për D.L, E.A, L.S, B.B, V.R-V; Procesverbalet e Komisionit Disiplinore të datës 26.12.2023, 18.12.2023, 15.12.2023, 13.12.2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë pjesërisht të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:*

Nga provat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit Ref.3/Nr.1, të datës 01.08.2022, është i punësuar në pozitën *Drejtor i Departamentit të Turizmit*, në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (me tej referuar MINT).

Tutje, sipas shkresave të lëndës, rrjedhë së më datë 01.12.2023, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka paraqitur kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me arsyetimin se: *sipas ankesës/deklaratës së z./ K.D-këshilltar i Lartë/Shef në Kabinetin e Ministres së MINT të paraqitur më datë 30.11.2023,*

me të cilin deklarohet për shkeljet e dyshuara të shkaktuar nga ankuesi (gjatë takimit të zhvilluar në Kabinetin e Ministres). Veprimet e tilla vlerësohen si shkelje e detyrave dhe përgjegjësi të punës dhe janë të përcaktuara me nenin 55 dhe 56 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenet përkatëse të Rregullores Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë...”, ndërsa, më datë 26.12.2023 ka paraqitur kërkesë tjetër për inicim të procedurës disiplinore për shkakun se: ..duke marr parasysh që nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat në fuqi për zyrtarët publik për veprimet e nëpunësit civil A.K për shkak se masa disiplinore e shqiptuar nuk është në përputhje me shkeljet e nëpunësit civil A.K gjithashtu A.K ka vazhduar me veprime në kundërshtim me ligjin për zyrtarët publikë, ku me postimit në rrjetet sociale ka dëmtuar rëndë imazhin/reputacionin e MINT/Qeverisë i cili njëkohësisht është edhe punëdhënësi i nëpunësit në fjalë, kurse L.S nuk ka reaguar/veprues sipas detyrave dhe përgjegjësi ligjore.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më Vendim me numër protokoll 1255/02, të datës 29.12.2023 ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi sipas nenit 56 paragrafi 4 nën paragrafët 4.6 dhe 4.7 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”.

Ankuesi në ankesën e parashtuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Komisioni Disiplinor ka vendosur për dy kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore e nuk ka bërë bashkimin e procedurave duke qenë se nuk kemi të bëjmë me çështje të njëjta dhe se për kërkesën e dytë për inicimin e procedurës disiplinore nuk është mbajtur fare seancë, ashtu që, ankuesit nuk i është dhënë mundësia e dëgjimit. Shton se Komisioni Disiplinor me vendimin e kundërshtuar ka konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të rregullave të përcaktuara në kodin e etikës, ndërsa, kodi i etikës nuk është në fuqi. Tutje, ankuesi pretendon se me asnjë provë nuk argumentohet se ankuesi ka pasur komunikim me këshilltarin e lart politik dhe e ka fyer apo kërcënuar dhe se gabimisht është konstatuar se nuk janë marr masat e duhura në raport me nëpunësit, ngase janë marr të gjitha masat dhe i është shqiptuar masa disiplinore vërejtje verbale. Si rrjedhojë, ankuesi kërkon që Këshillit të aprovoj ankesën si të bazuar, të anulohet vendimin e kundërshtar me ankesë dhe ankuesin ta kthejë në vendin e punës Drejtor i Turizmit si dhe ankuesit të bëhet kompensimi i pagave, shtesave dhe beneficioneve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës nga data 29.12.2023 deri në zbatimin e këtij vendimi.

Lidhur me kushtet e pranueshmerisë së ankesës, Kolegji i'u referua dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA) më të cilin përcaktohet se: *Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtuar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj, dhe si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës konstaton se ankesa është e pranueshme, ngase ankuesi ka legjitimitetin e palës dhe se ankesa është ushtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1, të LPPA-së, dhe si rrjedhojë Këshilli ka juridiksion për trajtimin kësaj çështje siç përcaktohet me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

Ndërsa, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve e të ankuesit, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë (i aplikueshëm nga data 26.09.2023) që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, me theks të veçantë:

Nenit 55 paragrafi 1: *“Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësive, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.*

Nenit 66, paragrafi 1 dhe 4 me të cilin është përcaktuar se: *“Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësive të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjisllacionin në fuqi”.*

Nenit 57 paragrafi 2 : *“ Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunëses/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil”.*

Nenit 58, paragrafit 2 me të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqiptimin e masave disiplinore: *“Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor”.*

Rrjedhimisht duke ju referuar kuadrit ligjor si me sipër, e në mbështetje të nenit 86 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit ka analizuar vendimin e kundërshtuar më ankesë në ndërlidhje me provat materiale të kësaj çështje

administrative, ku si rrjedhojë konstatoi se procedura disiplinore kundër ankuesit ishte iniciuar si pasojë e ankesës se datës 30.11.2023, të Këshilltarit të Lart Politik/ Shef i Stafit të ministres së MINT, , e parashtruar tek Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MINT-it, me arsyetimin se citojmë “ më datë 24.11.2023, rreth orës 15:00, zyrtari i lart i MINT, respektivisht Drejtori i Departamentit të Turzimit, përveç gjuhës nënçmuese e aspak profesionale të përdorur ndaj meje, pa pasur komunikim paraprak me te, kërcënon gojarisht, duke përdorura shprehjet citoj: “me ty shihemi tjetër ditë, tani e sheh ti”. Ky verpim përveç se jo profesional paraqet rrezikun potencial me të cilin ballafaqohemi secili nga ne, kur po i njëjti kërcënon gjatë komunikimit...” . Po ashtu, edhe këshilltarja politike në deklaratën e saj të dhënë pranë Komisionit Disiplinor kishte pohuar së “ me datë 24.11.2023..... paraprakisht doli nga takimi ku pa pritur u kthye nga dhe me zë të lartë duke përdorur edhe shprehjen me ty shihemi herën tjetër, tani e sheh ti ose merremi vesh ma ndryshe, andaj, mbi gjendjen e këtyre fakteve, Kolegji vlerëson së komunikimi i ankuesit me këshilltarin e lartë politik të ministres së MINT referuar gjuhës dhe shprehjeve të përdoruar, paraqet komunikim jo profesional dhe të papërgjegjshëm të ankuesit në raport me stafin politik, dhe së veprimet e tilla janë në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 9 të Rregullores (QRK) - NR.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përshihet se: *Nëpunësit civil janë të obliguar që të respektojnë dhe të sillen në mënyrë korrekte dhe të përgjegjshme ndaj stafit politik. 2. Duhet të ofrojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në mënyrë që të mbështesin dhe zbatojnë me nderë dhe paanshmëri politikat e përcaktuara nga institucionet e caktuara. 3. Nëpunësit civil duhet t'i ofrojnë stafit përkatës politik raporte të detajuara dhe me korrektësi në pajtim me ligjin”.*

Thënë me tepër, Kolegji konstaton se nuk ka mbështetje ligjore pretendimi ankimor i ankuesit së Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ka theksuar se pala ankuese ka bërë shkelje të rregullave të përcaktuara në kodin e etikës, ndërsa Kodi i etikës nuk është në fuqi, sepse, Qeveria e Kosovës më Vendimin Nr.10/109 të datës 23.11.2022, gjegjësisht me pikën 2.22 të këtij vendimi kishte shfuqizuar Rregulloren NR.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, mirëpo, me Vendimin 03/111 të datës 07.12.2022, Qeveria e Kosovës ka ndryshuar dhe plotësuar Vendimin Nr.10/109, të datës 23 nëntor 2022, ashtu që ka anuluar pikat 2.3, 2.6, 2.22, dhe pika 2.23 të Vendimit Nr.10/109, pra, Rregullorja Nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është në fuqi dhe si e tillë është e aplikueshme.

Rrjedhimisht si fakt relevant, për vendosje të drejt dhe meritore lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit mori edhe faktin se Këshilltari i Lart politik i ministres së MINT, në ankesën e tij të datës 30.11.2023 si dhe deklaratën pranë Komisionit Disiplinor kishte pretenduar së komunikimi me ankuesin në ngjarjen e datës 24.11.2023 ishte kërcënues dhe shqetësuese për te, stafin e kabinetit dhe koleget e tjerë të Shërbimit Civil, pretendime këto që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit bien në sferën penal, mirëpo që në shkresat e lëndës më asnjë dëshmi nuk vërtetohet së MINT kishte paraqitura kallëzim penal pranë organeve kompetente lidhur me kërcënimin e ankuesit ndaj këshilltarit të lartë politik të Ministres së MINT apo stafit tjetër siç pretendohet, nga ky i fundit.

Përkritazi me shkeljen disiplinore për mos veprime të ankuesit lidhur me nëpunësin civil dhe së masa e shqiptuar ndaj tij është masa me lehtë disiplinore, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i

provave të lëndës ka gjetur se më datë 13.12.2023, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MINT-it, kishte kërkuar nga ankuesi në cilësi të mbikëqyrësit, ndërmarrjen e veprimeve disiplinore ndaj nëpunësit civil me arsyetimin se i njëjti në profilin e tij në rrejtët sociale (Facebook) ka përdorë gjuhë të ashpër dhe të papërshtatshme ndaj menaxhementit të lartë të MINT. Kurse, në zbatim të kësaj kërkesë, ankuesi më datë 18.12.2023, ka shqiptuar ndaj nëpunësit civil masën disiplinore “Paralajmërim me shkrim” sipas nenit 57 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, e cila masë është shfuqizuar me Vendimin e Këshillit A.nr. 11/2024 të datës 04.03.2024. Andaj, nisur nga kjo gjendje e fakteve, rezulton fakti se në rastin konkret nuk kemi mos veprim apo neglizhencë të ankuesit kundrejt kërkesave të Zyrtarit me të Lartë Administrativ, sepse siç u vërtetua me lart, ankuesi kishte shqyrtuar kërkesën e datës 13.12.2023 të zëvendësit të Sekretarit të Përgjithshëm të MINT-it, dhe së i njëjti kishte dhënë masë disiplinore për zyrtarin, si vartës i tij.

Në kontekst të konstatimit si sipër, Kolegji ve theksin të kompetenca e organeve për shqiptimin e masave disiplinore, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 58 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku referuar kësaj baze ligjore rrjedhë se masat disiplinore për shkeljet e lehta shqiptohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë apo nga udhëheqësi më i lartë administrativ, ndërsa, referuar nenit 57 paragrafi 1 të këtij ligj, si m masa disiplinore që mund të shqiptohen për shkelje të lehta disiplinore janë: vërejtje verbale; paralajmërim me shkrim; dhe urrejtje me shkrim, andaj, nisur nga ky përcaktim ligjor, Kolegji konstaton se ankuesi në rastin konkret ka vepruar në pajtim me dispozita materiale pasi që i njëjti në pozitën e mbikëqyrësit mund të shqiptoj vetëm njëherë nga masat disiplinore për shkelje të lehtë disiplinore, e që ankuesi në rastin konkret kishte vlerësuar si masë të përshtatshme për nëpunësin masën “Paralajmërim me shkrim”, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit se ka ndërmarr të gjitha veprimet ndaj zyrtarit, është i bazuar dhe i argumentuar ligjërisht.

Përkitazi me pretendimin ankimor referuar faktit se Komisioni Disiplinor ka vendosur për dy kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore e nuk ka bërë bashkimin e procedurave ngase kërkesat nuk kanë qenë për çështje të njëjta dhe se ankuesi nuk ishte dëgjuar lidhur me kërkesën e dytë, Kolegji nga shqyrtimi i provave të lëndës konstatoi së fillimisht më datë 01.12.2023, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, ka parashtruar kërkesë për inicim e procedurës disiplinore ndaj ankuesi bazuar në ankesën e datës 30.11.2023 të Këshilltarit të lartë politik të ministres së MINT, ndërsa, më datë 26.12.2023, ka dorëzuar kërkesën e dytë për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit, me pretendimin se i njëjti nuk ka ndërmarr veprime ndaj nëpunësit dhe së masa disiplinore e shqiptuar ndaj tij nuk është në përputhje me shkeljet e nëpunësit. Rrjedhimisht, nga analizimi i Vendimit më numër të protokollit 1255/02 të datës 29.12.2023, Kolegji i Këshillit vëren se Komisioni Disiplinor kishte trajtuar të dy kërkesat e Zëvendës Sekretariatit të Përgjithshëm të MINT, duke e shpallur përgjegjës ankuesin për të dy shkeljet e pretenduara, ndërsa, bazuar në shkresat e lëndës nuk vërtetohet fakti së Komisioni Disiplinor kishte bërë bashkimin e kërkesave siç përcaktohet me nenin 84 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku thuhet se: *“1. Organi publik kompetent mund të bashkojë disa procedura administrative në një të vetme, nëse të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira bazohen në një gjendje faktike dhe bazë juridike të njëjtë apo të ngjashme. 2. Bashkimi i procedurave nuk kufizon të drejtën e palëve për të paraqitur kërkesa apo*

pretendime të ndryshmet..” andaj, duke qene së më asnjë prove nuk vërtetohet së Komisioni Disiplinor i MINT kishte bërë bashkimin e kërkesave të datës 01.12.2023 dhe 26.12.2023 për inicim të procedurave disiplinore ndaj ankuesit dhe meqenëse ankuesi ishte ftuar në seancë dëgjimore me datë 13.12.2023, pra, para se të iniciohet kërkesa e dytë për procedurë, dhe kështu ankuesit nuk i është dhënë mundësia e dëgjimit dhe kundërshtimit të pretendimeve sipas kërkesës së dytë të datës 26.12.2023, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor ka vepruar në kundërshtim menin 12 paragrafi 3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se: *3.Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: 3.1. Merr në pyetje ose merr deklarata nga dëshmitarët dhe verifikon faktet; 3.2. Rishikon dokumentacionin përkatës; 3.3. Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t’u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit; 3.4. Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes...*” rrejdhimisht, është i bazuar pretendimi i ankuesit mbi këtë bazë ankimore.

Referuar sqarimeve dhe të gjeturave të pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, si dhe marr parasysh faktin se organi i punësimit në këtë rast Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, nuk kishte ndërmarr ndonjë veprim në kuptim të përgjegjësisë penale të ankuesit, Kolegji i Këshillit konstaton së Komisioni Disiplinor i MINT-it me Vendimin me numër të protokollit 1255/02 të datës 29.12.2024, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike me rastin e konstatimit se ankuesi është përgjegjës lidhur me komunikimin dhe sjelljen jo te mirë me këshilltarin e lart politik të ministres së MINT dhe drejtë ka zbatuar ligjin material duke shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje disiplinore neni 56 paragrafi 4, nën paragrafi 4.6 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik. Ndërsa, Kolegji i Këshillit mbi arsyet e dhëna si me lartë vlerëson së Komisioni Disiplinor nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht nuk ka zbatuar drejtë ligjin material me rastin e konstatimit se ankuesi është përgjegjës në lidhje me mos veprimin ndaj nëpunësit civil. Andaj, Kolegji i Këshillit mbi bazën e këtij konstatimi vlerëson së masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit *“Largim nga shërbimi civil ”* është masë e rëndë disiplinore dhe si e tillë nuk është në proporcion me shkeljet e konfirmuara sipas këtij vendimi.

Thënë si më sipër, Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 55 paragrafi 1, nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.6, nenit 57 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 dhe nenin 61 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe në mbështetjeje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 13 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konstatoi se pretendimet ankimore të ankuesit janë pjesërisht të bazuara dhe vendosi që masën disiplinore largim nga shërbimi civil, të zëvendësoj me masën disiplinore *“Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë prej një (1) viti.*

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.137/2024

Nënshkruar më datë: 22.03.204

Vendimi i dërgohet:

- *Përfaqësuesit të ankueses*
- *Organit të punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*